



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 317, datë 27.4.2016

P Ë R

**PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT PUBLIK QË PËRFAQËSON SHTETIN
SI PRONAR TË AKSIONEVE TË SHOQËRIVE TË SEKTORIT
TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 48, pika 2, e 53, pika 3, të ligjit nr.43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, dhe të nenit 4, të ligjit nr.7926, datë 20.4.1995, “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Autoriteti publik, që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive Korporata Elektroenergjetike Shqiptare, sh.a., dhe Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, sh.a., është Ministria e Energjisë dhe Industrisë.
2. Autoriteti publik, që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të Operatorit të Sistemit të Transmetimit, sh.a., (OST), është Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.
3. Ministri i Energjisë dhe Industrisë dhe ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes emërojnë anëtarët e këshillave mbikëqyrës të shoqërive të përcaktuara në pikat 1 dhe 2, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, duke zbatuar kufizimet e përcaktuara në ligjin nr.43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, OST-ja aplikon menjëherë pranë Entit Rregullator të Energjisë, për certifikim, sipas procedurës së përcaktuar në nenin 58, të ligjit nr.43/2015.
5. Ministria e Energjisë dhe Industrisë ushtron të drejtat mbi OST-në, në përputhje me parashikimet e ligjit nr.43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", dhe fushën e tij të përgjegjesisë shtetërore.
6. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, ~~Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Korporata Elektroenergjetike Shqiptare, Operatori i Sistemit të Transmetimit, sh.a., dhe Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.~~

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

**MINISTRI I ENERGJISË
DHE INDUSTRIË**

DAMIAN GJIKNURI

NR.PROT.1652/3
DATE 25.4. 2016

MINISTRISË SË ENERGJISË DHE INDUSTRIË
MINISTRISË SË ZHVILLIMIT EKONOMIK,
TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES
MINISTRISË SË FINANCAVE
MINISTRISË SË DREJTËSISË
MINISTRIT TË SHTETIT PËR MARRËDHËNIET ME
PARLAMENTIN
KESH
OST
OSHEE
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjell AGACI

